

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7114
E shtunë, 10 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

Rama: Kosova dhe Serbia të përqendrohen plotësisht në dialog **1** PAGE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUPCHAN: KURTI DHE VUÇIQI PO E VËSHTIRËSOJNË ZGJIDHJEN DUKE LUAJTUR ME KARTA NACIONALISTE



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po bën veprime të panevojshme provokuese, thotë Charles Kupchan, profesor në Universitetin Georgetown dhe ish-drejtor i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara. "Nuk mendoj se kjo

është në interesin e Kosovës. Nëse kthehemi në vitin 1999 dhe menjëherë pas vitit 2008, Serbia është parë si problem, Serbia është parë si vend që e vështirësonte jetën, duke nxitur telashe në veri të Kosovës dhe duke refuzuar të angazhohej në normalizimin e

marrëdhënieve", thotë Kupchan në intervistën dhënë "Radios Evropa e Lirë". Sipas tij, të dy udhëheqësit - Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kanë mbetur te mosmarrëveshjet e së kaluarës, në vend se të fokusohen tek e ardhmja


NË KËSHILLIN E SIGURIMIT TË OKB-së KOSOVA DHE SERBIA PËRPLASEN PËR ÇËSHTJEN E DINARIT **F.7**



11 KOMUNA PËRFITUESE TË GRANTIT TË PERFORMANCËS NË VLERË RRETH 8 MILIONË EURO **F.6**



AKTUALE



BIDENI S'DO TË PËRBALLET ME AKTAKUZË PËR DOKUMENTET E KLASIFIKUARA, THOTË SE KUJTESËN E KA TË MIRË **F.2**

TAHIRI E NJOFTON SBASHK-un PËR NISMËN E AMENDAMENTIMIT TË LIGJIT TË PAGAVE **F.7**

QKUK-ja: MBI 2 MILIONË PARAMETRA TË ANALIZAVE LABORATORIKE GJATË VITIT 2023 **F.6**

EKONOMI



BEI INVESTOI 1,2 MILIARD EURO NË BALLKANIN PERËNDIMOR NË 2023-n **F.8**

BQK-ja LËSHON LINJË TELEFONIKE PA PAGESË PËR SERBËT E KOSOVËS NË LIDHJE ME DINARIN **F.8**

SPORT



KOSOVA MËSON KALENDARIN E NDESHJEVE NË LIGËN E KOMBEVE **F.10**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni s'do të përballet me aktakuzë për dokumentet e klasifikuara, thotë se kujtesën e ka të mirë

WASHINGTON, 9 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, e ka kundërshtuar ashpër një hetim ndaj tij i cili gjeti se ai i kishte keqpërdorur top dokumentet e klasifikuara dhe se kishte hasur në vështirësi t'i sillte ndër mend ngjarjet e rëndësishme jetësore. "Kujtesën e kam të mirë", u përgjigj Bideni me zemërim të enjten në Shtëpinë e Bardhë ndaj hetimit të prokurorit të posaçëm Robert Hur, duke e mohuar se kishte harruar se kur i kishte vdekur djali. Beau Biden vdiq nga kanceri në tru në vitin 2015, në moshën 46 vjeçe. "Si drejtin guxon ta ngrejë këtë çështje ai?", tha Bideni.

Hetimi gjeti se Bideni "me dashje i mbajti dhe i publikoi" dosjet e klasifikuara, por Hur tha se ka vendosur të mos ngrejë aktakuzë kundër tij.

Prokurori i posaçëm i Departamentit të Drejtësisë, Robert Hur, tha se Bideni i kishte mbajtur dokumentet e klasifikuara në mënyrë të papërshtatshme, të cilat kanë të bëjnë me politikën e jashtme

dhe ushtarake në Afganistan, pasi shërbeu si zëvendëspresident.

Në raport, i cili u publikua një ditë më parë, thuhet se kujtesa e presidentit ka "kufizime të mëdha".

Hur e intervistoi presidentin 81-vjeçar për pesë orë si pjesë e hetimit të tij.

Prokurori i posaçëm, një republikan i emëruar nga prokurori i përgjithshëm i Bidenit, Merrick Garland, tha se Bidenit nuk i kujtohej se në cilën kohë ishte zëvendëspresident (nga 2009 deri më 2017), apo "madje as kur djali i tij Beau kishte vdekur".

Në konferencën për media të së enjtes mbrëma, Bideni ishte emocional dhe i kritikoi gjetjet e hetimit se atij nuk i kujtohehin ngjarjet personale. "Sinqerisht, kur m'u bë ajo pyetje thashë me vete, kjo nuk është puna e tyre", tha Bideni. "Nuk kam nevojë që dikush të ma kujtojë se kur vdiq ai [Beau Biden]", shtoi ai.

Ai tha se ishte "shumë i zënë... duke u marrë me çështje të krizës ndërkombëtare" kur ishte



intervistuar nga prokurori i posaçëm nga 8 deri më 9 tetor 2023 - tamam kur shpërtheu lufta Izrael - Hamas.

Prokurori i posaçëm theksoi do të ishte e vështirë të dënohej presidenti për keqpërdorim të dosjeve, sepse "në gjykim, Bideni me gjasë do të prezantohej para jurisë, siç bëri edhe gjatë intervistës me ne, si një i

moshuar zemërdhembshur dhe me kujtesë të dobët".

Top dokumentet e klasifikuara u gjetën në Shtëpinë e Bidenit në Delaure dhe në ish-zyrën e tij private nga viti 2022 deri më 2023.

Zbulimi i tyre u bë pasi ndaj ish-presidentit amerikan, Donald Trump, u ngrit aktakuzë për keqpërdorimin e dokumenteve

të klasifikuara pas largimit të tij nga Shtëpia e Bardhë. Trump do të përballet me gjyqin në këtë rast në maj.

Raporti i Hurit përmend një dallim mes dy rasteve, duke thënë se Bideni i dorëzoi dokumentet në arkivat e qeverisë, ndërsa Trumpi "dysshohet se e bëri të kundërtën".

Të paktën 22 të vrarë nga sulmet izraelite në Gazë

GAZA, 9 SHKURT - Të paktën 22 persona janë vrarë, përfshirë gra dhe fëmijë, në katër sulme ajrore izraelite më 9 shkurt në pjesën qendrore të Rripit të Gazës dhe në qytezën jugore, Rafah, që gjendet në kufi me Egjiptin, thanë dëshmitarët dhe zyrtarët spitalorë.

Sulmet goditën një ndërtesë banimi në Rafah, duke vrarë tetë persona, dhe një çerdhe të shndërruar në strehimore për personat e zhvendosur në qytetin Zuvaida - në Gazën qendrore - ku u vranë pesë persona të tjerë. Ndërkaq, në një sulm në Deir al-Bala u vranë nëntë njerëz.

Mbi gjysma e popullsisë prej 2.3 milionë banorësh e Gazës ka ikur



për në Rafah, duke respektuar urdhrat për evakuim të lëshuar nga Izraeli, para zgjerimit të ofensivës së tij tokësore. Urdhrat për evakuim tani mbulojnë dy të tretën e territorit të enklavës së

vogël, e cila është rrethuar.

Edhe në zonat ku strehohen banorët, sikurse është Rafah, Izraeli vazhdimisht ka kryer sulme ajrore, pasi ka argumentuar se po sulmon

caqet e Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Izraeli mban përgjegjësin grupin radikal palestinez për numrin e lartë të viktimave civile, duke thënë se Hamasi operon brenda zonave civile. Të enjten presidenti amerikan Joe Biden tha se Izraeli po kryen një luftë "të tepruar".

Trupat tokësore izraelite ende janë të përqendruara në qytetin e Han Junisit, që gjendet në veri të Rafahut, por kryeministri Benjamin Netanyahu vazhdimisht ka paralajmëruar gjatë kësaj jave se Rafahu do të jetë synimi i radhës, duke krijuar panik në mesin e qindra mijëra

personave të zhvendosur. Paralajmërimet e Netanyahu kanë alarmuar, po ashtu Egjiptin, i cili ka thënë se çdo operacion tokësor në zonën e Rafahut, apo ndonjë zhvendosje e madhe përtej kufirit, do ta minonte traktatin 40-vjeçar të paqes që ka me Izraelin.

Lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit u nxit pasi grupi radikal palestinez kreu sulm në jug të Izraelit më 7 tetor, duke vrarë afër 1 200 persona, shumica civilë, dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Në Gazë, si pasojë e ofensivës izraelite, janë vrarë mbi 27 000 palestinezë, janë zhvendosur shumë të tjerë dhe çereku i popullsisë është në prag të urisë.

Ukraina i rrëzon 10 prej 16 dronëve me të cilët e sulmoi Rusia të premtën

KIEV, 9 SHKURT - Forcat e Mbrojtjes Ajrore të Ukrainës i kanë rrëzuar 10 nga 16 dronët me të cilët Rusia i sulmoi tri rajone të saj, Mikolain, Hersonin dhe Harkivin, mëngjesin e së premtes, thanë zyrtarët ukrainas.

Një person u plagos dhe u dëmtua infrastruktura civile

gjatë sulmit në Harkiv, tha guvernatori rajonal Oleh Synyehubov në Telegram. "Ekipet e shpëtimit e shuan zjarrin në një ndërtesë hoteli. Një roje sigurie civile u plagos. Ai mori tretman mjekësor në vendin e ngjarjes", tha ai. Ai shtoi se ndërtesat e banimit, një kompleks rekreativ trekatësh

dhe një restaurant, u dëmtuan nga sulmi.

Ushtria ruse i sulmon rregullisht rajonet e Ukrainës me lloje të ndryshme armësh, posaçërisht me dronë dhe raketa. Në janar Rusia shtoi sulmet e saj si rezultat i të cilave dhjetëra njerëz u vranë dhe qindra të tjerë u plagosën.



Në Këshillin e Sigurimit të OKB-së Kosova dhe Serbia përplasen për çështjen e dinarit

Kosova dhe Serbia hodhën akuza për vendimin për ndalimin e dinarit serb për pagesa në Kosovë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Serbia e cilësoi si "sulm ndaj serbëve", ndërkaq Kosova tha se rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës synon t'i mbrojë qytetarët nga aktivitetet e paligjshme

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Nju-Jork, 9 shkurt - Në seancën e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë shkëmbyen akuza të rënda, përfshirë rreth zbatimit të vendimit për kufizimin e importit të dinarit serb në Kosovë, ndërkohë që ambasadorët e vendeve perëndimore kërkuan nga palët të përmbahen nga veprimet e njëanshme që mund të çojnë drejt përshkallëzimit të situatës.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, që kishte kërkuar seancën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së në Nju-Jork për të diskutuar për zhvillimet në Kosovë, akuzoi kryeministrin Albin Kurti se po pamundëson jetën e serbëve që jetojnë atje. "Institucionet e Kosovës kanë krijuar kushte të padurueshme të jetesës për serbët dhe tani ata po ndërmarrin sulme gjithëpërfshirëse, sistematike kundër civilëve serbë, si dhe po i përdjekin ata. Një situatë e tillë, në mungesë të një reagimi të duhur, mund të shkaktojë dëm të riparueshëm për mbijetesën e popullit serb në Kosovë", ka deklaruar Vuçiqi, duke shtuar se ata varen nga mbështetja financiare e buxhetit të Serbisë për pensionet dhe shërbimet e tjera bazë, përfshirë ato të kujdesit mjekësor dhe social, si dhe të arsimit.

Sipas tij, vendimi për heqjen nga qarkullimi të dinarit është "goditje e drejtpërdrejtë ndaj mbijetesës së serbëve dhe të themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë". "Është pikërisht krijimi i kushteve të padurueshme të jetesës dhe mohimi i mundësisë për të mbijetuar që ka për qëllim regjimi në Prishtinë, i cili, përmes akteve të këtuja të dhunës strukturore, po shton sulmet sistematike kundër popullatës serbe, të cilat janë mirë të planifikuara me vite dhe përmes të cilave përndjekja e hapur e serbëve në Kosovë ka filluar", ka thënë ai.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili për herë të parë mori pjesë në një seancë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i hodhi poshtë si të pavërteta akuzat e Vuçiqit dhe tha se institucionet e Kosovës do të sigurojnë një tranzicion për serbët e Kosovës rreth përdorimit të dinarit serb. "Beogradi po i bie kabanës... për shkak se po ndalojmë thasë parash në kufi. Po ankohen jo për shkak se janë të brengosur për fatin e serbëve të Kosovës, por për shkak se është gati t'u mbyllet kanali fitimprurës i

parasë së jashtëligjshme në veri të Kosovës", është shprehur kryeministri Kurti.

Ai e ka akuzuar Serbinë se po sillet si "kali i Trojës i Kremlinit" në rajon dhe shtoi se "rregullorja në asnjë mënyrë nuk ndalon dhe as nuk pengon Qeverinë e Serbisë që t'u japë përkrahje financiare serbëve të Kosovës". "Çfarëdo pretendimi për të kundërtën nuk është asgjë më shumë se propagandë e rreme që ka për qëllim të nxisë tensione etnike", ka thënë Kurti. Sipas tij, Beogradi nuk mund të lejohet pafundësisht t'i financojë kriminelët dhe terroristët e tij në Kosovë me shuma parash që qarkullojnë lirshëm dhe jashtëligjshëm në vendin tonë.

Ambasadorja amerikane në OKB, Linda Thomas-Greenfield, ka kritikuar Prishtinën për veprime të pakoordinuara dhe Beogradin për shmangie të përgjegjësive për sulmin në Banjskë vitin e kaluar. Ajo u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të përmbahen nga "veprimet e pakoordinuara dhe përshkallëzuese" dhe kritikoi institucionet e Kosovës për "veprimet e fundit të pakoordinuara" ndaj institucioneve komunale të mbështetura nga Serbia në pjesën perëndimore të Kosovës dhe ndaj organizatës joqeveritare "Qendra për Paqe dhe Tolerancë" në Prishtinë. "Këto veprime nuk përputhen me përkushtimin e Kosovës për të punuar përmes dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian për t'u dhënë përgjigje çështjeve që prekin miqësinë e minoritetit serb", ka deklaruar ajo, duke shtuar se: "Dhe ato dëmtojnë rrugëtimin drejt normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë".

Thomas-Greenfield ka theksuar se zbatimi i vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës është bërë "pa përgatitje të mjaftueshme apo konsultime me popullatën vendase". "Përsërisim thirrjen që



zbatimi i këtij plani të shtyhet menjëherë deri në vendosjen e procedurave të duhura në përputhje me standardet dhe praktikatat evropiane... dhe popullata e prekur të jetë informuar", ka thënë ambasadorja Thomas-Greenfield. Sipas saj, pengesat për shpërndarjen e fondeve nga Serbia "duhet të minimizohen" gjatë kësaj periudhe të tranzicionit. Përfaqësuesja amerikane në OKB gjithashtu përsëriti dënimin e sulmeve "të koordinuara, të dhunshme paraushtarake serbe ndaj policisë së Kosovës" në Manastirin e Banjskës më 24 shtator, gjatë të cilit u vra një polic i Kosovës. "Katër muaj kanë kaluar që nga ky sulm dhe Serbia ende nuk po i mban përgjegjës ata që janë të përfshirë në planifikimin dhe ekzekutimin e tij. Në fakt, udhëheqësi i vetëshpallur i sulmit mbetet i lirë në Serbi", ka theksuar ajo, duke i bërë thirrje Serbisë "t'i mbajë plotësisht përgjegjës drejtuesit dhe organizatorët e sulmit të 24 shtatorit". "Serbia duhet, gjithashtu, të punojë me

KFOR-in për t'u siguruar që një sulm i tillë të mos përsëritet".

Ambasadorja amerikane Thomas-Greenfield ka thënë se dialogu për normalizim në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë nën udhëheqjen e BE-së dhe jo në OKB. Përfaqësuesi i Francës në OKB tha se ka nevojë për stabilizim të situatës në terren dhe që Kosova dhe Serbia të punojnë për normalizimin e raporteve.

Parisi zyrtar u bëri thirrje palëve të shmangin çdo veprim të njëanshëm që do të mund t'i nxiste tensionet.

Franca tha se është e shqetësuar me rregulloren e BQK-së dhe mbylljen e institucioneve në Kosovë, duke argumentuar se këto ngjarje mund të kenë ndikim në jetën e serbëve.

Çështja e strukturave paralele serbe, sipas Francës, duhet të zgjidhet përmes krijimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Ky shtet, po ashtu, kërkoi të mbahen përgjegjës të përfshirët në sulmin në Banjskë.

Franca kërkoi që Kosova ta

pezullojë zbatimin e rregullores së BQK-së.

Përfaqësuesi i Slovenisë në OKB kërkoi nga Kosova dhe Serbia të vazhdojnë të përkushtohen ndaj dialogut, duke shtuar se përparimi dhe normalizimi janë thelbësore që të dyja palët ta vazhdojnë rrugën e tyre drejt BE-së.

Sa i përket vendimit për ndalimin e dinarit, Slovenia shprehu shqetësim për serbët që marrin mbështetje financiare nga Serbia, por vuri në pah se autoritetet në Kosovë kanë mundësuar një periudhë tranzicioni.

Mbretëria e Bashkuar tha se veprimet e fundit të Kosovës kanë pasur për synim t'i rregullojnë operacionet me valuta të huaja, por zbatimi i rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës deri më tani ka treguar se ka shpërfillur ndikimin që kjo rregullore ka ndaj komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Përfaqësuesi i Mbretërisë së Bashkuar bëri thirrje për vazhdimin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja dhe kërkoi që Kosova dhe Serbia t'i respektojnë zotimet ekzistuese të dialogut dhe të shmangin veprime të njëanshme. Mbretëria e Bashkuar, po ashtu, i bëri thirrje Serbisë t'i mbajë përgjegjës personat që u përfshin në sulmin në Banjskë.

Zvicra bëri thirrje që Kosova dhe Serbia të përmbahen nga veprimet që mund ta tensionojnë situatën.

Ky shtet tha se ndan shqetësimet lidhur me rregulloren e BQK-së sa i përket njoftimit të publikut me të, por pranoi se autoritetet kanë vendosur një periudhë tranzitore. Zvicra kërkoi që Kosova dhe Serbia ta zbatojnë Marrëveshjen drejt normalizimit dhe Aneksin e zbatimit të saj si dhe të përfshirët në sulmin në Banjskë të mbahen përgjegjës.

Mbledhja e KS-së komentohet në mënyra të ndryshme në Prishtinë

Mbledhja e KS-së në Kosovë është komentuar në mënyra të ndryshme. Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka thënë se në Këshillin e Sigurimit të OKB-së fuqitë kryesore perëndimore si ShBA-ja, Britania dhe Franca, nuk pajtohen për asnjë temë ndërkombëtare me kundërshtarët e tyre lindorë, Rusinë dhe Kinën, por një politikë e brendshme dhe e jashtme e gabuar e Qeverisë Kurti ka bërë që të gjithë të pajtohen që të thirret mbledhja e Këshillit të

Sigurimit e kërkuar nga Serbia, gjë që tregon se sa keq qëndron ndërkombëtarisht Republika e Kosovës si një vend pa drejtim dhe pa orientim.

Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka thënë se monedha e dinarit u ndërkombëtarizua deri në Këshillin e Sigurimit. "Kur shefi i pare i UNMIK-ut, De Melo, provonte të na bindte se në Kosovë duhet të vazhdojnë ligjet që kanë qenë në fuqi para luftës, pra edhe

dinari, ne i përmbysëm këto insistime të OKB-së. Sot me pazotësinë e Kurtit dinari u bë çështje ndërkombëtare, në vend se të promovohet suksesi ynë që atëherë u bëmë shteti i parë që përdorte valutë evropiane dhe jo jugosllave. Gjatë okupimit zbatuam markën gjermane, pas luftës euron. Kosova ka shënuar suksese historike, por ja që solli një kryeministër që i kthen mbrapa arritjet tona", ka shkruar Tahiri në "Facebook".



Kupchan: Kurti dhe Vuçiqi po e vështirësojnë zgjidhjen duke luajtur me karta nacionaliste

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po bën veprime të panevojshme provokuese, thotë Charles Kupchan, profesor në Universitetin Georgetown dhe ish-drejtor i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara. “Nuk mendoj se kjo është në interesin e Kosovës. Nëse kthehemi në vitin 1999 dhe menjëherë pas vitit 2008, Serbia është parë si problem, Serbia është parë si vend që e vështirësoonte jetën, duke nxitur telashe në veri të Kosovës dhe duke refuzuar të angazhohej në normalizimin e marrëdhënieve”, thotë Kupchan në intervistën dhënë “Radios Evropa e Lirë”. Sipas tij, të dy udhëheqësit - Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kanë mbetur te mosmarrëveshjet e së kaluarës, në vend se të fokusohen tek e ardhmja

PRISHTINË, 9 SHKURT - Kishte një debat të nxehtë mbrëmjen e së enjtes midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Ata u përballën në një mbledhje të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për ndalimin e dinarit serb në Kosovë. Si e komentoni ju debatin rreth kësaj çështjeje?

Charles Kupchan: Ky është edhe një tjetër raund i dialogut të ashpër në mes të Kurtit dhe Vuçiqit. Pavarësisht prej faktit se Marrëveshja e Ohrit, e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, është në tryezë, marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë duket se po kthehen prapa dhe nuk po ecin përpara. Unë mendoj se kryeministri Kurti është duke bërë disa veprime të panevojshme provokuese. Ka qenë çështja e letërnjoftimeve, e targave, e instalimit të kryetarëve

[shqiptarë] në veri, për të cilët ka votuar një përqindje shumë e vogël e banorëve... tani u thotë serbëve se nuk mund t'i përdorin dinarët më, ekziston vetëm një monedhë zyrtare dhe ajo është euroja. Ai ka të justifikueshme këto gjëra? Po, sepse çdo vend sovran duhet të jetë në gjendje të thotë se ne kemi monedhën tonë, euro... ose të ketë një autoritet përgjegjës për lëshimin e targave. Por, duket se Kurti po i ndërmer këto veprime duke luajtur me një kartë nacionaliste - me ç'gjë e vështirëson përparimin e Marrëveshjes së Ohrit.

Unë nuk mendoj se kjo është në interesin e Kosovës. Nëse kthehemi në vitin 1999 dhe menjëherë pas vitit 2008 [kur Kosova ka shpallur pavarësinë], Serbia është parë si problem, Serbia është parë si vend që e vështirësoonte jetën, duke nxitur telashe në veri të Kosovës dhe duke refuzuar të angazhohej

në normalizimin e marrëdhënieve. Tani Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kritikojnë Kosovën.

Pra, nga një këndvështrim i gjerë, nuk jam i sigurt se këto veprime - edhe nëse janë të justifikueshme për sa iu përket të drejtave sovranë - janë të dobishme.

Me çfarë sfidash potenciale mund të përballët Kosova në aspektin e mbështetjes dhe partneritetit ndërkombëtar?

Charles Kupchan: Mendoj se kemi dëgjuar tashmë disa paralajmërime të hidhura, në formën e mesazheve të qarta, se Kosova nuk do të jetë në rrugën e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare - BE, NATO - nëse nuk ec në rrugën e normalizimit. Flitet edhe për çështjen e ndihmës ekonomike.

Tani për tani, këto janë pjesë e bindjes, e komunikimit diskret me

kryeministrin Kurti dhe anëtarët e tjerë të Qeverisë së Kosovës që të sillen në mënyrë më konstruktive. Por, një pjesë vjen edhe në formën e disa llojeve të dënimeve, në përpjekje për ta kthyer Prishtinën në një drejtim më pozitiv.

Gjithsesi, unë nuk dua të them se Vuçiqi është një person bashkëpunues, i cili është i gatshëm të bëjë marrëveshje me Kosovën. Ai luan me kartën e tij nacionaliste, ai bën dhe thotë gjëra provokuese, po ashtu. Pra, kjo është një rrugë dydrejtimeshe. Do të duhen kompromise të dhimbshme nga të dyja palët për t'i zgjidhur këto mosmarrëveshje të kahershme.

Më lejoni t'i kthehem takimit në Këshill të Sigurimit, ku Vuçiqi tha se “jeta e serbëve në Kosovë po bëhet e pamundur”, ndërsa Kurti tha se Serbia “duhet ta ndalojë financimin e kriminelëve dhe terroristëve në Kosovë”. Ku mund të çojë kjo retorikë?

Charles Kupchan: Kemi parë tashmë incidente, përfshirë dhunën e turmës së armatosur në Banjskë. Kemi dëgjuar se Serbia i ka mobilizuar forcat e saj të armatosura, në përgjigje të kësaj dhune. NATO-ja ka diskutuar rritjen e nivelit të forcës së saj brenda Kosovës, si mënyrë për ta ruajtur paqen dhe për t'u siguruar që dhuna të mos shpërthejë. Por, vetë fakti se po diskutojmë për një rikthim të mundshëm në dhunë, që biseda ka marrë një kthesë të

tillë... mendoj se është një shenjë se ne nuk jemi në një pozitë të mirë tani. Unë mendoj se kjo është edhe një nga arsytet përse Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e tyre në Evropë e kanë shtuar angazhimin diplomatik, duke u folur hapur dhe drejtpërdrejt të dyja palëve - Prishtinës dhe Beogradit - për rëndësinë e ecjes përpara dhe të normalizimit.

Kur bëhet fjalë për normalizimin e marrëdhënieve, a duhet ta shtyjë Kosova zbatimin e vendimit për dinarin?

Charles Kupchan: Po. Nëse shohim se çfarë përfiton Kosova kundrejt kostos së një vendimi të tillë, mendoj se duhet të lihet në pritje. Nuk kemi nevojë për më shumë masa që rrisin tensionet.

A po i mban Serbia institucionet paralele? Po. A po u dërgon Serbia fonde serbëve në veri? Po. A po bën gjëra që i inkurajojnë serbët që të mos integrohen plotësisht në Kosovë? Po. E përsëris, kjo është një rrugë me dy drejtime.

Por, mua më duket se nuk është një investim i mirë e afatgjatë për Qeverinë në Prishtinë që të bëjë gjëra që në bashkësinë ndërkombëtare shihen si provokuese dhe të panevojshme.

Në Këshillin e Sigurimit kishte thirrje edhe për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. A mendoni se mosmarrëveshjet e

Që nga liberalizimi i vizave nuk janë raportuar raste të mosrespektimit të rregullave, thotë Gashani

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ministria e Punëve të Brendshme ka mbajtur takimin e rregullt me atashetë e migrimit të ambasadave të huaja në Kosovë me qëllim për të diskutuar për trendet e përgjithshëm të migrimit, me theks të veçantë lëvizjet migratore, si dhe monitorimin e procesit të lëvizjes së qytetarëve të Kosovës pas procesit të liberalizimit të vizave.

Në këtë takim koordinatori Kombëtar për Migrim, njëherësh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, ka theksuar se menaxhimi i migracionit është ndër politikat më të rëndësishme të institucioneve të Kosovës. Ai ka thënë se që nga fillimi i zhvillimit të politikave të migracionit të artikuluara në kuadër të dokumenteve strategjike, fokusi kryesor ka qenë te parandalimi i migracionit të parregullt dhe organizimi i migrimit të sigurt, të organizuar dhe të rregullt. Dhe, sipas tij, kjo qasje e ndërtuar ndër vite ka dhënë rezultatet e saj dhe tashmë tendencat e migracionit, veçanërisht

migracioni i parregullt nga Kosova drejt Bashkimit Evropian, ka shënuar një zvogëlim të ndjeshëm, ndërsa trendi i migracionit të rregullt, veçanërisht për qëllime të punësimit, është në rritje. "Siç jeni në dijeni, nga data 1 janar 2024 ka filluar lëvizja e lirë në zonën Shengen për qytetarët e Republikës së Kosovës, e drejtë kjo e fituar me shumë punë dhe përkushtim. Si institucione kemi bërë përgatitjet e duhura për të menaxhuar këtë proces, duke përfshirë informimin e qytetarëve tanë lidhur me të drejtat dhe obligimet që derivojnë nga kjo liri e lëvizjes. Në bazë të raporteve, të cilat i kam pranuar nga mekanizmat përgjegjës institucionalë deri më tani, çdo gjë është duke shkuar në suaza normale dhe nuk janë raportuar raste të mosrespektimit të rregullave", theksoi zëvendësministri Gashani.

Në këtë takim zëvendësministri Gashani vuri në dukje se në fushën e legjislacionit gjatë tremujorit të parë të këtij viti, në



bazë të planit legjislativ të qeverisë, presin të miratojnë Ligjin e ri për të Huajt, si një ndër ligjet bazike që rregullon fushën e migracionit në Republikën e Kosovës. "Në kuadër të këtij projektligji kemi përfshirë disa çështje me rëndësi, të cilat padyshim se do ta avancojnë sistemin për menaxhimin e

migrimit në vend. Fokus i veçantë u është kushtuar parimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe direktivave të BE-së që kanë të bëjnë me trajtimin dhe kthimin e migrantëve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Kosovës", ka theksuar

zëvendësministri Gashani. Në këtë takim u diskutuan për çështje të ndryshme për fushën e migrimit. Në këto diskutime morën pjesë përfaqësues të Policisë së Kosovës, zyrtarë të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, atashë, si dhe organizata që mbështesin fushën e migrimit.

Rama: Kosova dhe Serbia të përqendrohen plotësisht në dialog

PRISHTINË, 9 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e konsideron të pakuptimtë seancën e mbajtur në OKB për dinarin, në të cilën ishin të pranishëm kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti serb Aleksandar Vuçiq.

Kreu i qeverisë shqiptare ka theksuar se Kosova dhe Serbia duhet të përqendrohen plotësisht në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe të fokusohen në arritjen e marrëveshjeve. Derisa shprehet se Shqipëria qëndron pranë Kosovës në parandalimin e çdo kërcënimi të jashtëm, ai shton se do të vazhdohet t'i theksohet lidhshmëria të Kosovës rëndësia e koordinimit të ngushtë me aleatët e saj



kryesorë. "Ishte një seancë pakuptim. Këshilli i Sigurimit i OKB-së është e qartë se nuk është vendi për asgjë që lidhet me Kosovën. Si dy vende sovranë që

aspirojnë anëtarësimin në BE, Kosova dhe Serbia duhet të përqendrohen plotësisht në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe të fokusohen në arritjen e

marrëveshjeve për qarkullimin financiar, shërbimin postar, taksimin e dyfishtë dhe të gjitha çështjet e tjera që përfitojnë jetën e përditshme të njerëzve të zakonshëm. njerëzve, duke siguruar edhe një të ardhme paqësore për brezat e ardhshëm. Ndërsa qëndrojmë pranë Kosovës në parandalimin e çdo kërcënimi të jashtëm, Shqipëria do të vazhdojë t'i theksojë lidhshmërinë të Kosovës rëndësia e koordinimit të ngushtë me aleatët e saj kryesorë. Qëndrimi i palëkundur dhe i vazhdueshëm së bashku me ta tregon ndjenjën e vizionit dhe përgjegjësisë shtetërore, ndërkohë që çdo rast i qëndrimit të vetëm në rrugën e njohjes së plotë e zbeh

pozitën e vendit në sferën publike të marrëdhënieve ndërkombëtare", ka shkruar Rama në "Twitter".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, hodhën akuza në drejtim të njëri-tjetrit në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që u mbajt të enjten në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vuçiqi e akuzoi Kurti se qeveria e tij po përndjek serbët në Kosovë, ndërsa Kurti i akuzoi Vuçiqin dhe Serbinë se vazhdimisht bëjnë përpjekje për ta penguar sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë dhe se tenton ta 'terrorizojë' Kosovën.

fundit mund ta ndikojnë atë?

Charles Kupchan: Asociacioni ka qenë pengesë prej fillimit. Me sa kuptoj, problemi tani mund të përshkruhet në këtë mënyrë: "cila është më e vjetër - pula apo veza". BE-ja ka nxjerrë një propozim [vj. draft-statutin për Asociacionin] që Kurti e ka pranuar, por ka thënë se nuk do ta zbatojë atë derisa Vuçiqi ta nënshkruajë Marrëveshjen [e Ohrit]. Vuçiq thotë: si mund ta nënshkruaj marrëveshjen nëse ju nuk i keni ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar Asociacionin dhe për t'u siguruar serbëve nivelin e vetëqeverisjes që është në përputhje me marrëveshjen? Unë mendoj se jemi afër marrëveshjes, por mosmarrëveshjet që i pamë në Këshill të Sigurimit, retorika e ashpër që shohim si nga Vuçiqi, ashtu edhe nga Kurti, nuk i ndihmojnë gjërat.

A mendoni se mund të gjendet ndonjë qasje alternative që mund t'i përmbushë të dyja palët?

Charles Kupchan: Unë mendoj se kompromisi, i cili është në fokus, është tërheqës. Janë dashur vite punë. Ka pasur negociata të vështira në Bruksel, në Ohër, bisedime të tjera, presion nga ShBA-ja dhe BE-ja. Unë do të hezitohja të thosha se kjo nuk po funksionon dhe po kalojmë në planin B. Mendoj se, së paku tani për tani, Marrëveshja e Ohrit është e mirë. Dhe, është e rëndësishme që të gjendet një mënyrë për të bindur Kurtin dhe Vuçiqin që të vazhdojnë me kompromiset, me vendimet e vështira politike që duhet t'i marrin. Një pjesë e problemit me këto bllokada për dinarin dhe mosmarrëveshje të tjera, lidhet me debatin e ashpër dhe me

grindjet mes liderëve. E gjithë kjo ndikon në qëndrimet e publikut. Kjo, pastaj, e vështirëson marrjen e vendimeve të vështira për Kurtin dhe Vuçiqin, sepse ata nuk besojnë se opinioni i tyre publik i mbështet. Kjo e ndërlikon situatën, sepse, në fund, Kurti dhe Vuçiq duhet ta ndajnë mbështetjen e popullatës së tyre dhe të dy duhet të bëjnë një punë më të mirë në përgatitjen e qytetarëve për t'u ofruar mbështetje. Kjo do të kërkojë deklarata publike dhe edukim më të fokusuar në të ardhmen, e jo përsëritje të mosmarrëveshjeve nga e kaluara.

Muajin e ardhshëm do të bëhet një vit nga Marrëveshja e Ohrit dhe nuk kishite ndonjë përparim të rëndësishëm në zbatimin e saj...

Charles Kupchan: Ky është një realitet i kthjellët.

Këtë vit ka zgjedhje në Shtetet e Bashkuara. Çfarë mund të presë Kosova nga një mandat i dytë i presidentit Joe Biden dhe çfarë nga mandati i mundshëm i presidentit Donald Trump? **Charles Kupchan:** Është interesante që administrata e Trumpit - e cila nuk ka qenë aspak pro-atlantike, nuk ka qenë shumë e prirë drejt Evropës, BE-së dhe NATO-s - është angazhuar në Kosovë, duke siguruar një marrëveshje që synonte përmirësimin e marrëdhënieve ekonomike me Serbinë. Në njëfarë mënyre, është bërë një përjashtim në qasjen e gjerë të administratës Trump ndaj Evropës. Kështu që, unë nuk dua të sugjeroj se nëse Trump zgjidhet, kjo vëmendje e ShBA-së do të zhduket. Mendoj se është e vështirë të konstatohet përse ai është fokusuar në këtë çështje,

përse është angazhuar në atë mënyrë. Trump është një person disi i paparashikueshëm. Nëse Biden rizgjidhet, mendoj se do të jemi dëshmitarë të angazhimit të mëtejshëm, të diplomacisë dhe të trysnisë së madhe. Unë, gjithashtu, besoj se nëse Trump zgjidhet, ai do të vazhdojë në të njëjtën rrugë, për të gjetur një zgjidhje për mosmarrëveshjet e kamotshme [mes Kosovës dhe Serbisë]. ShBA-ja, partnerët evropianë dhe aktorë të tjerë duhet të vazhdojnë t'i inkurajojnë të dyja palët që të pajtohen. Do të ishte gabim të thuhet që kjo marrëveshje e ka një vit, por nuk po zbatohet, ndaj duhet harruar. Mendoj se ky është ndoshta shansi më i mirë që nga viti 2008, kur Kosova ka shpallur pavarësinë, dhe ne duhet të vazhdojmë të punojmë për të përfutur prej saj

11 komuna përfituese të grantit të performancës në vlerë rreth 8 milionë euro

Komunat që u shpërblyen janë Rahoveci, Obiliqi, Skenderaj, Suhareka, Peja, Kaçaniku, Shtimja, Malisheva, Dragashi, Ranillugi dhe Parteshi



EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë, Zvicrën, Suedinë dhe Norvegjinë, kanë ndarë rreth 8 milion euro për Grantin e Performancës Komunale (GPK). Ky grant iu nda 11 komunave me performancën më të mirë, sipas një sistemi indikatorësh të shpërndarë në tri fusha kryesore: qeverisja demokratike, menaxhimi komunal dhe ofrimi i shërbimeve publike. Komunitet që u shpërblyen janë Rahoveci, Obiliqi, Skenderaj, Suhareka, Peja, Kaçaniku, Shtimja, Malisheva, Dragashi, Ranillugi dhe Parteshi. Përmes këtij granti komunat do të investojnë në projekte kapitale që do ta përmirësojnë jetën e qytetarëve. Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi, në fjalimin e tij ka theksuar rëndësinë e ngritjes së cilësisë në

administratën publike e cila duhet të jetë e hapur, transparente dhe llogaridhënëse. “Reforma në administratën publike është prioritet qeveritar. Praktikën e shteteve në Evropë kanë dëshmuar se një administratë publike efikase, moderne, transparente dhe llogaridhënëse janë çelës i të gjitha reformave të tjera”, ka theksuar Bislimi. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, vuri theksin se Granti i Performancës Komunale është instrument i qeverisë, që mbështet komunat financiarisht, mbi bazën e parimit të meritës dhe i rangon ato në baza vjetore, sipas performancës së tyre. “Ceremonia e Grantit të Performancës është përmbyllje e një procesi i cili përfshinë raportim, kontroll dhe vlerësim, gjithmonë objektiv, transparent dhe të paanshëm. Përmes këtij granti ne synojmë të mbështesim projekte të cilat

bazohet edhe në rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve siç janë shtimi i hapësirave të gjelbra, rregullimi i shtratit të lumenjve apo reduktimi i hapësirave me mbeturina”, ka thënë Krasniqi. Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka përgëzuar komunat përfituese të Grantit të Performancës Komunale duke theksuar mbështetjen e Bashkimit Evropian për qeverisjen lokale. “BE-ja është jashtëzakonisht krenare të jetë pjesë e këtij mekanizmi inovativ që nxit performancën komunale dhe i sjell qytetarët më afër administratave të tyre lokale. Përmirësimi i efikasitetit të komunave të Kosovës është aspekt kyç i qeverisjes së mirë. Administrata publike që është llogaridhënëse, transparente dhe funksionon mirë përmirëson jetën e qytetarëve dhe kontribuon në mirëqenien e tyre”, ka deklaruar Szunyog. Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jurg Sprecher, ka theksuar se ndikimi i Grantit të

Performancës Komunale të komunat përfituese është i dukshëm, teksa vlerësoi bashkëpunimin dhe angazhimin e të gjitha palëve për suksesin e këtij granti. “Ne e vlerësojmë dhe përgëzojmë punën e palodhshme dhe përkushtimin e zyrtarëve komunalë, kryetarëve të komunave, drejtorëve dhe anëtarëve të Kuvendeve Komunale. Ky përkushtim jo vetëm që rrit performancën e komunave por, gjithashtu, fuqizon qeverisjen demokratike lokale, përmirëson cilësinë e jetës për qytetarët dhe rrit kënaqshmërinë e qytetarëve”, ka thënë ai. Zëvendësambasadori i Suedisë, Henrik Riby, në fjalimin e tij ka theksuar rëndësinë e angazhimit të qytetarëve në proceset vendimmarrëse në Kosovë, për t’iu përgjigjur më mirë nevojave të qytetarëve, në veçanti grupeve të margjinalizuara. “Suedia vlerëson shumë ndërtimin e

besimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, pasi është thelbësore për një kulturë të fortë demokratike. Demokracia vërtet ka sukses kur qytetarët marrin pjesë në mënyrë aktive. Ministria së bashku me kryetarët e komunave dhe ekipet e tyre janë si arkitektë, që i kthejnë idetë në rezultate të prekshme për qytetarët e tyre. Është e domosdoshme që qytetarët të bëhen vendimmarrës në procesin e zgjedhjes së projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre”, është shprehur Riby. Granti i Performancës Komunale financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Demos për t’i përkrahur komunat në projekte komunale. Nga viti 2014 deri në vitin 2023 grante në vlerë totale prej 33.5 milionë eurosh u janë dhënë 33 nga 38 komunave. Këto grante kanë financuar 430 projekte, duke ndikuar pozitivisht në jetën e një milion qytetarëve.

QKUK-ja: Mbi 2 milionë parametra të analizave laboratorike gjatë vitit 2023

PRISHTINË, 9 SHKURT - Klinika e Biokimisë në Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK) ka shënuar rezultate rekorde në realizim të numrit,

llojit dhe parametrave laboratorike, të realizuara për pacientët e shtrirë në klinikat e QKUK-së, por edhe ata ambulatorë.

Gjatë vitit 2023 janë realizuar mbi 2 milionë parametra laboratorike për analiza të ndryshme, numër ky rekord, krahasuar me vitin 2021 dhe

2022. Në vitin 2022 ishin realizuar 1 milion e 700 mijë parametra, kurse në vitin 2021, 1 milion e 800 mijë parametra.



Hotelet e Kosovës priten mbi 54 mijë vizitorë vetëm në dhjetor

PRISHTINË, 9 SHKURT - Biznesi i hotelerisë çdo muaj është duke realizuar profit, pasi duket se hotelet janë mjaft të frekuentuara. Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se vetëm në muajin dhjetor numri i vizitorëve nëpër hotele ishte për 40 për qind më i lartë sesa në po të njëjtin muaj të vitit 2022.

Sipas të dhënave të ASK-së, në këtë periudhë hotelet patën mbi 54 mijë vizitorë.

“Në dhjetor 2023, numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) në hotele ishte 54 832, prej tyre 40.1 për qind ishin vendorë dhe 59.8 për qind ishin të jashtëm. Krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2022 (sa ishin 42 042 vizitorë) kishte rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 30.4 për qind. Numri i net qëndrimeve ishte 145 619, prej tyre 43.9 për qind nga vendorët dhe 56.0 për qind

nga të huajt”, ka njoftuar ASK-ja.

Ndërsa numri i vizitorëve të jashtëm dhe net-qëndrimet e tyre në hotele sipas shteteve nga vijnë është: “Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (dhjetor 2022) ka rritje të vizitorëve për 25.1 për qind. Në total 32 835 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh është nga Shqipëria, Zvicra, Gjermania, Turqia etj”, ka njoftuar ASK-ja.



‘Raportet e mira Kosovë - Gjermani do të fuqizohen edhe më tej në të ardhmen’

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHKURT - Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë i Kuvendit të Kosovës, udhëhequr nga kryetarja e Komisionit, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, ka pritur të premten në takim një delegacion të Grupit të Evropës Juglindore të Parlamentit të Gjermanisë. Kryetarja e Komisionit, Kryeziu-Hyseni, e falënderoi delegacionin nga Gjermania për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania i ka ofruar Kosovës, para dhe gjatë luftës, si dhe përkrahjen që është duke

treguar gjatë procesit të shtetndërtimit dhe integritit të Kosovës.

Në vijim të takimit u diskutua për një gamë të gjerë çështjesh me qëllim të një koordinimi më të mirë ndërmjet dy vendeve, me theks të veçantë bashkëpunimi ndërparlamentar.

Kryetarja e Komisionit, Kryeziu-Hyseni, si dhe anëtarët e tjerë të komisionit, vlerësuan lart angazhimet e Gjermanisë dhe përpjekjet e saj konkrete për integrimin e rajonit.

Lidhur me këtë u nënvizua angazhimi gjerman për Procesin e Ballkanit të Hapur, ide kjo që buron dhe përkrahët pa rezervë

nga diplomacia gjermane.

Në emër të delegacionit gjerman foli Josip Juratoviq, i cili vuri në spikamë miqësinë dhe bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve. Ai tha se Kosova dhe Gjermania kanë ndërtuar raporte të mira dhe miqësore dhe vlerësoi, po ashtu, se ato do të fuqizohen edhe më tej në të ardhmen.

Ndërkaq, duke iu referuar zhvillimeve të fundit në vendin tonë, Juratoviq u angazhua për një bashkëpunim më të ngushtë dhe konsultim paraprak.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim delegacionin e

Grupit të Evropës Juglindore të Parlamentit të Gjermanisë, të drejtuar nga Josip Juratoviq.

Në takim u diskutua për proceset aktuale në Kosovë, për marrëdhëniet midis dy vendeve dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërshtetëror në fusha të ndryshme.

Kreu i Kuvendit e njoftoi delegacionin parlamentar gjerman me proceset nëpër të cilat po kalon vendi dhe punën e institucioneve të Kosovës për përmbushjen e detyrave që dalin para tyre në këto procese, me theks të veçantë, në rrugëtimin për t’u bërë pjesë e strukturave euroatlantike.

Konjufca vlerësoi se Gjermania ishte në krah të Kosovës dhe qytetarëve të saj në çdo fazë të shtetndërtimit e të zhvillimit dhe potencoi rëndësinë e kësaj përkrahjeje në sfidat dhe objektivat që vendi ynë ka para vetes, në aspektin e brendshëm, ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar.

Udhëheqësi i delegacionit të Bundestagut, Josip Juratoviq, duke falënderuar kryetarin Konjufca për pritjen, vlerësoi miqësinë midis dy vendeve dhe popujve tanë, përderisa konfirmoi vazhdimin e mbështetjes së vendit të tij për Kosovën edhe në të ardhmen.

Tahiri e njofton SBASHK-un për nismën e amendamentimit të Ligjit të Pagave

PRISHTINË, 9 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka pritur në takim kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj, me të cilin ka diskutuar edhe njëherë për Ligjin për Skemat Pensionale, i cili diskriminon pensionistët kontributdhënës, më së

shumti mësimdhënësit.

Lidershipin e SBASHK-ut Tahiri e ka njoftuar se grupi parlamentar i AAK-së ka dorëzuar tek Avokati i Popullit ankesën rreth këtij diskriminimi dhe se janë në mbështetje të plotë të ndalimit të këtij diskriminimi, duke përfshirë edhe kontestimin e ligjit në

Gjykatën Kushtetuese. “Po ashtu, SBASHK-un e informova edhe për iniciativën tonë për ta filluar amendamentimin e Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, si veprim për të bërë pagë të dinjitetshme për të punësuarit në administratën shtetërore”, ka deklaruar Tahiri.



BEI investoi 1,2 miliard euro në Ballkanin Perëndimor në 2023-n

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 SHKURT - BEI Globale, krahu financiar i Bankës Evropiane të Investimeve (BEI) për aktivitete jashtë Bashkimit Evropian, investoi një vlerë rekord prej 1,2 miliardë eurosh në të gjithë Ballkanin Perëndimor më 2023 (365 milionë euro më shumë se në 2022).

Investimet shkuan në projekte të qëndrueshme dhe të tranzicionit energjetik që mbështesin përpjekjet e rajonit për anëtarësim në BE, si dhe përpjekjet ekonomike, klimatike dhe ato të lidhjes. "Fondet mbështesin projektet në kuadër të planit ekonomik dhe të investimeve, dhe nismës Global Gateway, instrumente strategjike të BE-së për t'i kapërcyer boshllëqet ekzistuese

infrastrukturore dhe për t'i përmirësuar standardet e jetesës. Në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian, ne kemi kënaqësinë të ofrojmë një grant mbresëlënës prej 475 milionë eurosh në kuadër të kornizës së investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe nismës për rimëkëmbje ekonomike të BEI-t", tha Kyriacos Kakouris, zëvendës-president i BEI-t, përgjegjës për rajonin.

Pjesa më e madhe e fondeve të reja (58 %, ose 693 milionë euro) është ndarë për transport më të sigurt dhe të qëndrueshëm, përkatesisht për linjat hekurudhore në Serbi (Beograd-Nish) dhe Maqedoninë e Veriut (Kriva-Palanka-kufiri me Bullgarinë).

Banka e BE-së nënshkroi fonde shtesë për modernizimin e transportit urban në Sarajevë dhe një projekt për rehabilitimin dhe sigurinë e rrugëve në Serbi. 275



milionë euro (23 % e financimit total në 2023) iu kushtuan mbështetjes së bizneseve të vogla dhe të mesme (NVM) në Ballkanin Perëndimor. Fondet e mbetura do të shkojnë për projektet e energjisë, ujit, shëndetësisë dhe arsimit. "Falë partneriteteve në kuadër të Team Europe me partnerët tanë të Ballkanit Perëndimor, Komisionin Evropian dhe institucionet financiare ndërkombëtare, ne mund të shfrytëzojmë sa më shumë nga burimet këshillimore dhe financiare për t'i maksimizuar përfitimet për njerëzit në rajon. Ne mirëpresim paraqitjen e planit të ri të rritjes së propozuar nga Komisioni, i cili do t'i përshpejtojë reformat kryesore që promovojnë prosperitetin më të madh

ekonomik, avancimin e konvergencës me Bashkimin Evropian dhe forcimin e nismave rajonale si tregu i përbashkët rajonal", tha zëvendës-presidenti Kakouris.

Përveç financimit, Banka ofroi mbështetje teknike këshillimore për përgatitjen dhe zbatimin e një projekti të shpërndarjes së ujit në Tiranë, si dhe një linjë kredie për veprimet klimatike për NVM-të në Maqedoninë e Veriut.

Sipas programit JASPERS të financuar nga BE-ja, kapaciteti i disponueshëm këshillimor teknik për Ballkanin Perëndimor pritet të trefishohet, me një buxhet prej 20 milionë eurosh në dispozicion për gjashtë vitet e ardhshme.

Avancimi vetëm drejt tranzicionit të gjelbër në rajon

Mbi 61 % e projekteve të nënshkruara në vitin 2023 për Ballkanin

Perëndimor kontribuojnë drejtpërdrejt në veprimet për klimën dhe qëndrueshmërinë mjedisore - në përputhje me qëllimet e BEI-t për klimën. Banka e BE-së nisi projekte të reja në energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë dhe infrastrukturën e energjisë së pastër.

Në konferencën e ndryshimeve klimatike COP28, BEI Globale, ka njoftuar qasjen e saj të re, të projektuar për ta rritur financimin dhe shërbimet këshillimore në nivel global, në mbështetje të tranzicionit dhe rimëkëmbjes së drejtë. Lidhur me aktivitetet fillestare të tranzicionit, fokusi do të vendoset në Bosnjë-

Hercegovinë, Kosovë*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Në konferencë, Banka u bashkua gjithashtu me nënshkruesit e një deklaratë për platformën e investimeve të tranzicionit të drejtë për Maqedoninë e Veriut, që synon të ndihmojë në mobilizimin e deri në 3 miliardë eurove për ta përshpejtuar vendosjen në punë të kapacitetit të energjisë së rinovueshme 1,7 GW deri në vitin 2030.

Në bashkëpunim me bankat tregtare dhe institucionet kombëtare të zhvillimit si Banka e Zhvillimit e Maqedonisë së Veriut, BEI Globale ofroi 275 milionë euro në formë kredie të përbalueshme për NVM-të për t'i ndihmuar ato të zgjerohen dhe krijojnë vende pune, duke përmirësuar njëkohësisht ndikimin e tyre social dhe klimatik.

Disa linja kreditimi përfshijnë gjithashtu një komponent "të gjelbër", që mbështet energjinë e pastër dhe projektet e masave për klimën në sektorin privat.

Lidhur me linjën e saj novatore të kredisë me ndikim financiar, të njoftuar në vitin 2020 në vendet e Ballkanit Perëndimor, banka e BE-së mori një çmim prestigjioz Uxolo në 2023. Kredia nxit punësimin e të rinjve, barazinë gjinore dhe praktikatat shoqërore gjithëpërfshirëse, me shpërblime financiare për kompanitë që përmblin objektivat e punësimit afatgjatë.

Së fundi, Fondi Evropian i Investimeve (FEI), pjesë e Grupit të BEI-t, filloi zbatimin e instrumentit të garancisë së WB EDIF për qëndrueshmërinë e NVM-ve, që pritet të zhblokojë rreth 700 milionë euro për NVM-të në rajon. Deri më sot Grupi i BEI-t ka investuar mbi 6 miliardë euro në sektorin privat në Ballkanin Perëndimor.

BQK-ja lëshon linjë telefonike pa pagesë për serbët e Kosovës në lidhje me dinarin

PRISHTINË, 9 SHKURT - Banka Qendrore e Kosovës, me qëllim të ofrimit të informatave plotësuese në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, për qytetarët e Republikës së Kosovës ka lëshuar në funksion linjën pa pagesë 0800 222-55. Kjo linjë është e dedikuar për qytetarët nga komuniteti serb që jetojnë në Republikën e Kosovës dhe kanë nevojë të informohen drejt dhe konkretisht.


Përkujtojmë se Rregullorja për Operacione për Para të Gatshme: Nuk ndalon apo kufizon pranimin e mjeteve në llogaritë bankare në euro në bankat e licencuara; Nuk kufizon aktivitetin këmbimor të cilësdo valutë që kryhen nga institucionet financiare bankare ose jobankare të licencuara nga BQK-ja; Nuk ndalon transferet nga asnjë shtet; dhe nuk ndalon posedimin dhe kursimin në

asnjë valute jo-euro (përfshirë dinarin).

Të gjithë individët kanë qasje në llogari bankare dhe mund të pranojnë mjete në llogaritë e tyre në euro. "Qytetarët që ende nuk kanë llogari mund të hapin një të tillë te secila bankë, sipas Rregullores së BQK-së për qasje në Llogari Pagese për Shërbime Bazike, që për grupet e cenueshme e të skemave sociale nuk ka tarifë të hapjes e as të mirëmbajtjes nga 1 janari 2024. Vetëm në katër komunat veriore operojnë katër degë bankare, tri institucione mikro-financiare (kredidhënëse) si dhe mbi 15 institucione financiare jobankare për pagesa dhe këmbimore. Numri i degëve dhe zyrave të institucioneve financiare që operojnë në atë zonë është në rritje, pasi përfshirja financiare është objektiv i BQK-së", ka njoftuar BQK-ja.



Ku gabon bota kur merret me “civilizimin”?



Nga: **Josephine QUINN**,
profesoreshë e
Historisë Antike në
Universitetin e Oksfordit /
The Financial Times
Përkthimi: *Telegrafi.com*

Të gjithë janë të shqetësuar për Perëndimin. Për disa ai është nën sulm nga refugjatët, nga terroristët apo nga aktivistët [wokery]. Për të tjerët problemi është te vetë Perëndimi i cili i gjithmonë i imponon vlerat e veta si një e mirë universale. Por, askush nuk është i sigurt se çfarë është në të vërtetë – ose, më mirë, ku ndalet.

Puna ishte më lehtë kur kishte Perde të Hekurt që ndante saktë sferën komuniste dhe atë kapitaliste. Më pas erdhi 11 Shtatori dhe një thyerje e re mes Perëndimit liberal demokratik dhe botës islame. Tani terreni sërish po ndryshon, pasi “vendet moderne arabe” janë ftuar t’i bashkohen betejës së Benjamin Netanyahu për “qytetërimin perëndimor” kundër Hamasit. Këto ditë është e zakonshme të dëgjosh politikanët që flasin për qytetërimet në shumës dhe në format sipërfaqësore pluraliste. Në një fjalim në tetorin e kaluar në Klubin e Diskutimit Valdai – një think-tank i Moskës i lidhur me Kremlinin – Vladimir Putini shpjegoi se “ka shumë qytetërimet dhe asnjëri nuk është më superior apo më inferior ndaj tjetrit. Janë të barabartë, meqë

secili përfaqëson një shprehje unike të kulturës, të traditave dhe të aspiratave të popullit të vet”. Natyrisht, kryesorja për të është Rusia, “shteti original civilizues” që “nuk mund të ndahet”, dhe sigurisht jo nga ajo që ai e paraqet – në të njëjtin fjalim – si puç ilegal në Ukrainë më 2014. Ky “koncept i politikës së jashtme” është homologu historik i botës moderne “multipolare” të cilin Putini e mbron si alternativë ndaj “rendit të bazuar në rregullat” perëndimore.

Në Kinë, në ndërkohë, Xi Jinpingu ka nisur një Iniciativë të re të Qytetërimin Global, për të çmuar “qytetërimet unike dhe të gjata” të botës ... “që kapërcejnë kohën dhe hapësirën”. Ashtu si në Rusi, ideja e një kulture të fortë dhe të unifikuar kombëtare, të rrënjësuar në historinë e lashtë, e forcon pretendimin politik dhe moral: për Xinë, qëndrueshmëria e qytetërimin kinez “përcakton nivelin themelor të cilin kinezët duhet ta ndjekin rugën e vet”. Dhe, kjo mënyrë e të menduarit për qytetërimet, si të barabarta ama të dallueshme, ka arritur në zemrën morale të Perëndimit: katër universitete greke dhe katër kineze, vitin e kaluar në Athinë – porti antik i Pireut i së cilës tani është në pronësi të linjave shtetërore kineze të transportit – u bashkuan për të nisur një qendër të qytetërimet të lashta kineze dhe greke.

Ideja e një bote me qytetërimet, në formën e saj moderne u shfaq

në fund të Luftës së Ftohtë. Në vitin 1996, politologu i Harvardit, Samuel P. Huntington, e shtroi rastin parashikues për konfliktin midis qytetërimet si tipar përcaktues për një epokë të re, duke argumentuar se dallimet kryesore mes njerëzve tani janë më shumë kulturore dhe fetare sesa politike dhe ekonomike.

Ai i identifikoi nëntë qytetërimet bashkëkohore, duke përfshirë atë “perëndimor”, “ortodokse” dhe “islamike”, por gjithashtu ai vetë qytetërimet i projektoi thellë në të kaluarën e tyre: “Historia njerëzore është histori e qytetërimet. Është e pamundur të mendohet zhvillimi i njerëzimit në ndonjë term tjetër”. Dhe, nuk është për t’u habitur – nëse gjithashtu besoni, siç bëri Huntingtoni – se “gjatë pjesës më të madhe të ekzistencës njerëzore, kontaktet midis qytetërimet ishin të ndërprera ose joekzistente”.

Mendimi qytetëruar i këtij lloji varet nga një ide e kulturave të veçanta që rriten si pemë individuale në një pyll, me rrënjët dhe degët e tyre të dallueshme nga ato të fqinjëve. Shfaqen, lulëzojnë dhe bien, dhe këtë e bëjnë kryesisht si të vetme. Rritja dhe ndryshimi janë rezultat i zhvillimit të brendshëm, jo i lidhjeve të jashtme. Qytetërimet mund të ndryshojnë emrat e vet sipas këtij modeli, por ato nuk e ndryshojnë natyrën e vet. Sido që t’i shpjegoni, qytetërimet mund të duken si fakte të

natyrshme për botën, kështu që të vetmet pyetje interesante janë ato se si disa ia dalin më mirë se të tjerët ose pse përplasen. Por, ato janë krijesa moderne, të shpikura nga studiuesit e shekullit XIX për të theksuar epërsinë e kombeve të tyre dhe drejtësinë e perandorive të tyre. Fjala “civilizim” shfaqet për herë të parë në Francë në vitet 1750, prezantuar nga Marquis de Mirabeau. Bashkëkohësit folën për shoqërinë e sjellshme, ose qytetërimin, duke e dalluar Evropën moderne nga e kaluara e saj feudale dhe duke shoqëruar këtë me rritjen e tregtisë. Por, mirësjellja shpeshherë ishte fytyra e cektësisë, hipokrizisë dhe korrupsionit, dhe për Mirabeau, siç ka shpjeguar historiani i Kembrixhit, Michael Sonenscher, “qytetërimi” i vërtetë kishte një dimension moral që njerëzisë thjesht i mungonte.

Pra, adoptimi më i gjerë i fjalës, gjatë dekadave në vijim, ishte produkt i idealeve iluministe të universalizimit dhe përparimit historik njerëzor – për shembull, siç argumentuan filozofët skocezë, nga gjuetarët te barinjët, te fermerët, te tregtarët ose, sipas filozofit gjerman Hegel, nga idhujtarët te politeistët e te protestantët.

Qytetërimi, në këtë aspekt, ishte qëllimi përfundimtar i lulëzimit njerëzor dhe teorikisht i arritshëm për gjithë popullsinë e botës – edhe nëse evropianët e konsideronin veten më të

përshtatshëm për ta arritur atë. Ideja ndihmoi në justifikimin e sipërmarrjeve perandorake evropiane në Indi dhe në Azinë Lindore si mision kulturor për të përmirësuar jetën dhe mendjen e të kolonizuuarve. Siç tha historiani skocez James Mill në vitin 1810, “kjo qeveri angleze në Indi, me të gjitha veset e saj, është bekim me përmasa të papërshkrueshme për popullsinë e Industanit”.

Në shekullin XIX, ky koncept në njëjës u shpërbë pasi studiuesit identifikuan qytetërimet të shumta të lidhura me rajone specifike, të ndara dhe rrallëherë të barabarta. Ky “mendim qytetëruar” në shumës, shtoi një element mbrojtës te nocionet e epërsisë kulturore evropiane: idenë e kulturave të dallueshme që jo vetëm ishin të ndryshme, por që gjithmonë kanë qenë – dhe gjithmonë do të jenë. Shumë prej tyre kishin kufij të natyrshëm në përparimin e vet, ashtu si “racat” njerëzore që hynë në fokusin shkencor në të njëjtën kohë. Ndërkohë, strategjitë kombëtare perandorake hynë në një fazë më të drejtpërdrejtë shfrytëzuese dhe të dhunshme, duke kulmuar me mizoritë e kryera në Kongon belgjianë.

Historiani intelektual Georgios Varouxakis, në vitet 1840 e ka gjurmuar frazën “qytetërim perëndimor” që madje edhe atëherë ishte koncept dredharak. Në mesin e shekullit XIX, “Perëndimi” veçse e shënoi një kufi me interesat ruse për



Shkolla e Athinës, afresk i pikturuar mes viteve 1509-1511 nga Rafaeli, tregon shkencëtarët, filozofë dhe matematikanë nga bota antike

komentuesit në të dy anët e atij kufiri; në fund, fokusi nga ana perëndimore u shtri në Islam. Në vitin 1891, Edward Freeman, profesor në Universitetin e Oksfordit botoi Historinë e Sicilisë nga kohët më të hershme që e bëri të njëjtin kundërshtim themelor midis banorëve të lashtë grekë dhe fenikas të ishullit, si dhe banorëve të mëvonshëm të krishterë dhe myslimanë: çështja qendrore që duhej luftuar, siç tha ai, ishte “nëse ishulli qendror i detit qendror duhej t’i përkiste Perëndimit apo Lindjes, trungut arian apo semit”.

Rrënjët e Perëndimit ishin gjithashtu të turbullta, por studiuesit ranë dakord se ato ishin vendase, duke arritur deri në brigjet e Mesdheut klasik, te pyjet gjermane ose te fortifikimi problematik i të ashtuquajturit krishterim mesjetar.

Si klasiciste jam kontradiktore. Vendi i Greqisë dhe Romës në thelbin e qytetërimit perëndimor ka qenë vazhdimisht qendror në fushën sime, dhe kjo nuk zhduket: çdo vit, kandidatët në Oksford më thonë se kjo është ajo që i solli ata në lëndën time. Ata gjithashtu nuk gabojnë. Është e vërtetë që athinasit e lashtë ishin skllëvër entuziastë dhe supremacistë mashkullorë. Por, bota klasike mund të ofrojë gjithashtu frymëzim për Perëndimin modern, me modelet për demokraci radikale ose drama të fuqishme të traumave të refugjatëve dhe

tmerreve të luftës.

Si historiane, e di që mendimi për civilizimin është thjesht i gabuar. Kulturat lokale dhe rajonale vijnë dhe shkojnë, por ato krijohen dhe mbështeten nga ndërveprimi. Takimet e përfshira nuk duhet të jenë miqësore. Por, janë pikërisht ato lidhje që nxisin ndryshimin historik, nga varkat që sollën gomarin afrikan dhe rrotën euroaziatike në Egje në mijëvjeçarin e tretë p.e.s., e deri te anijet e pajisura me busullën kineze që dërguan evropianët në Amerikë 4000 vjet më vonë për ta pushtuar atë vend me barutin kinez.

Këtë e dinin edhe grekët dhe romakët. Ata e ndanë botën jo nga raca, nga kultura apo nga besimi, por nga klima dhe ekologjia. Një tekst mjekësor grek i shkruar rreth vitit 400 p.e.s., i quajtur Ajrërat, ujërat, vendet, shpjegon se për shkak se në Azi temperatura është relativisht e qëndrueshme dhe klima e butë, gjërat rriten mirë dhe gjithçka është e bukur dhe e madhe, përfshirë njerëzit. Ata janë gjithashtu të butë dhe të dashur, por u mungon guximi dhe qëndrueshmëria, sipërmarrja dhe shpirti i lartë. Për dallim, evropianët janë më të ashpër, më të guximshëm dhe më luftarak – si dhe më të egër, të pashoqërueshëm dhe më pasionantë.

Pretendimi nuk është se aziatikët apo evropianët sillen natyrshëm në ndonjë mënyrë të veçantë: është se mjedisi inkurajon sjelljet

e veçanta, si midis atyre që kanë lindur në ato vende ashtu edhe te vizitorët. Aristoteli ndërkohë e caktoi vetë Greqinë midis Azisë dhe Evropës, në më të mirën e të dy botëve.

Autorët klasikë në secilin rast u përqendruan më shumë te lidhjet. Romakët e theksuan rëndësinë e takimeve dhe shkëmbimeve në një botë në lëvizje të vazhdueshme: poeti Katuli mund të imagjinonte udhëtimin me miqtë në Indi, Arabi, Parthi, Egjipt dhe madje edhe te “britonët në skaj të botës”, ndërsa Plini Plaku – dijetari më i famshëm polimat që më së shumti njihet për vdekjen duke hetuar shpërthimin e Vezuvit në vitin 79 të e.s. – pohoi se vetëm indianët kurrë nuk kanë migruan.

Ndërkohë, legjendat greke i lidhnin heronjtë e vet të gjakut dhe të lëvizjes me mbretëreshat, mbretërit dhe perënditë e vendeve të huaja: fenikasit, frigianët dhe amazonët. Dhe, studiuesit grekë i pranuan borxhet që kanë: Platoni shprehu mirënjohje për egjiptianët që shpikën matematikën, geometrinë dhe astronominë, ndërsa Herodoti shpjegoi se alfabeti grek erdhi nga Fenicia dhe se në Greqi njihej si shkronjat fenikase.

Ai kishte të drejtë në të dyja aspektet, dhe ardhja e alfabetit ishte më revolucionare sesa që mund të tingëllojë. Me sa duket, është më e natyrshme që njerëzit të regjistrojnë rrokje sesa tinguj

individualë: ka shumë shembuj në mbarë botën të rrokjeve të zhvilluara në mënyrë të pavarur, por të gjitha alfabetet moderne nuk mund të kthehen në një sistem të vetëm shkrimi të zhvilluar nga folësit e një gjuhe levantine – paraardhëse e gjuhës fenikase, hebraike dhe aramaike – gati 4000 vjet më parë. Njëpërmjet Fenicisë dhe Greqisë arriti në Romë dhe në Perëndim modern. Arabishtja mori nga aramaishtja. Përrashtimi i vetëm është hanguli korean, krijimi personal i Sejongut të Madh në XV të e.s. për të përmirësuar nivelet e shkrim-leximit në mbretërinë e tij.

Ajo që as Herodoti nuk dinte është se shkronjat fenikase nuk u shpikën në Levant. Përkundrazi, shenjat e para të identifikuara në mënyrë të sigurt si shkronja alfabetike, u gjetën në minierat mbretërore egjiptiane të bruzit, në malet e Sinaït, të skalitura aty rreth vitit 1800 p.e.s. nga punëtorët e ftuar levantinë, duke përshtatur hieroglifet – që nuk mund t’i lexonin – për të regjistruar një gjuhë të cilën më parë nuk ndjenin se duhej shkruar.

Leximi dhe shkrimi në gjuhën e folur mund të duket gjë e natyrshme sot, veçanërisht për anglishtfolësit. Por, për shumikënd është zgjedhje relativisht e kohëve të fundit, ndërsa në antikitet ishte e pazakontë. Komunikimi formal në Levant ndodhte në gjuhët e perandorive më të mëdha, mbi të

gjitha në akadishten babilonase e cila ishte e shkruar me shkrim kuneiform (kunjor) me qindra shenja për fjalë dhe për rrokje të ndryshme.

Shkrim-leximi ishte aftësi e veçantë, e mësuar me shumë mund dhe vetëm nga skribët, derisa shpikësit e alfabetit shpikën një truk të pastër. Secila prej “shkronjave” të tyre fillimisht ishte një imazh i vogël, duke sinjalizuar për ta tingullin e parë të fjalës për objektin e përshkruar. Pra, shenja për “a” ishte koka e një demi, “alef” në gjuhën levantine, “b” ishte një shtëpi skematike ose “bet”, e kështu me radhë. Meqë shenjat përfaqësonin tinguj, jo rrokje, kishte shumë më pak prej tyre. Dhe, gjithsesi nuk ju duhej t’i mësoni ato: thjesht duhej të njihje gjuhën dhe trukun.

Jeta jashtë vendit ishte ajo që ua dha këtyre emigrantëve levantinë arsytet për të shkruar gjërat për herë të parë, për të komunikuar me njëri-tjetrin dhe perënditë e tyre, dhe ua dha atyre mjetet e reja për ta bërë këtë: vetë ata i huazuan piktogramet e tyre alfabetike nga shenjat egjiptiane që panë përreth.

Alfabeti nuk ishte i vetmja risi e Azisë Perëndimore që arriti në Mesdheun klasik në fazën e tij formuese: Levanti ka qenë gjithmonë udhëkryq i shkëmbimit kulturor. Fjalët semite të marra nga greqishtja shpeshherë kanë të bëjnë me biznesin dhe tregtinë, dhe sipërmarrësit levantinë duhet t’i



Ideja e civilizimit evropian u përdor për t'i arsyetuar ndërmarrjet imperialiste. Këtu, përfaqësuesi anglez nga East India Company është përshkruar shumë më lart mbi ata që e rrethojnë

kenë mësuar greqishtfolësit me teknologjitë financiare të Azisë Perëndimore, si bankat e depozitave, sigurimet detare dhe garancitë për huamarrje.

Në anën tjetër, numrat e përdorur në Perëndimin modern anashkaluan plotësisht Greqinë dhe Romën. Grekët numëruan me shkronjat e tyre të reja alfabetike, ndërsa romakët huazuan një sistem bazë të numërimit nga fqinjët që flisnin gjuhën etruske. Numrat tanë të pavarur u shpikën në Indi rreth vitit 250 p.e.s., duke u ndërtuar mbi një sistem numërimi shumë më të vjetër mesopotamian që përdorte kolona të ndryshme për numra të fuqive të ndryshme. Studiuesit indianë e ruajtën këtë notim të pozicionit, prandaj 11-shi tani do të thotë njëmbëdhjetë dhe jo dy, por ata i zëvendësuan pykat kuneiforme – me të cilat babilonasit numëronin në grupe prej 60 – me numra individualë nga 1-10 dhe më pas e përsosën sistemin me shpikjen e zeros.

Këta numra indianë arritën të studiuesit arabë në Bagdad në shekullin e nëntë të erës sonë, duke zëvendësuar edhe atje përdorimin e shkronjave alfabetike: si rezultat, numrat në arabisht nuk shkruhen ende nga e djathta në të majtë, si pjesa tjetër e gjuhës, por si në Indi nga e majta në të djathtë. Nga shekulli XII, udhëtarët e krishterë aventurierë si Adelardi i Bathit u ndeshën me këta numra “indo-arabë” në mbretëritë islame të

Evropës Jugore, por atyre iu desh shumë kohë për t'i adaptuar: edhe në vitin 1500, shumica e evropianëve ende përdornin numra romakë.

Historitë e tilla duket se kanë pak të bëjnë me rritjen e izolacionizmit populist në ShBA dhe në Evropë gjatë dekadës së fundit. Por, edhe pse kjo shpeshherë shprehet në terma nacionalistë, ajo bazohet në një shqetësim më të madh për një trashëgimi unike perëndimore ku Greqia e lashtë dhe Roma rrëmbehen lehtësisht si shenjë e superioritetit kulturor evropian, ose thjesht racor, të cilin vetë grekët dhe romakët do ta kishin konsideruar si ide absurde. Nacionalistët e bardhë amerikanë, që nga Revolucioni i Teksasit në vitet 1830 e deri në Kapitoll në 2021, valojnë flamujt me fjalët apokrifë molon labe – “eja dhe merre” – gjoja drejtuar nga një mbret spartan pushtuesve persianë.


Promovuar për herë të parë nga aktivisti francez Renaud Camus në librin e tij të vitit 2011, Zëvendësimi i madh, teoria se popullsia e bardhë apo vendase evropiane po zëvendësohet nga emigrantët në një formë të kolonizimit të kundërt, tani është element kryesor i teoricienëve të konspiracionit të djathtë, supremacistëve të bardhë dhe turmave çjerrëse në mbarë botën. Kjo retorikë helmuese varet shumë nga ideja e një qytetërimi të veçantë – francez,

britanik, perëndimor apo i bardhë – që është nën kërcënim nga kulturat e ndryshme dhe të huaja dhe veçanërisht nga fëmijët e tyre.

Por, vetë ideja e qytetërimit është problemi i vërtetë, dhe në veçanti nocioni se është një lojë me

shumën zero, me kultura më të larta nën kërcënimin e vlerave të huaja migrante dhe fertile. Nuk ka pasur kurrë kulturë të pastër perëndimore që tani është nën kërcënimin e ndotjes. Asnjë popull i vetëm nuk është ishull, përveç nëse ata kanë qenë atje

për një kohë shumë të gjatë dhe nuk kanë shpikur varka. Dhe, kjo është një gjë e mirë: pa marrëdhënie të reja midis njerëzve të ndryshëm që shkëmbejnë ide të panjohura, asgjë fare nuk do të ndodhte. /Telegrafi/



Pllakë kuneiforme e zbuluar në Naxhaf të Irakut që daton nga shekulli XXII-XI p.e.s.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Rugova pas dorëheqjes: Ishte nder dhe krenari që i shërbeva qytetit tim

PRISHTINË, 9 SHKURT - Granit Rugova është larguar nga pozita e drejtorit për sport në Prishtinë pasi një ditë me parë Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës e prishën koalicionin e tyre në kryeqytet. Ish-basketbollisti i njohur ka thënë se ishte nder dhe krenari jetësore që i shërbeu qytetit të tij. "Ishte nder dhe

krenari jetësore t'i shërbej qytetit tim të dashur dhe sportit të Prishtinës. Për dy vjet, i udhëhequr nga përkushtimi maksimal dhe pasioni i thellë për sportin dhe qytetin, së bashku me kolegët, sportistët, klubet dhe gjithë komunitetin e sportit, për herë të parë ngritëm sportin e Prishtinës në nivel ndërkombëtar. Nën

udhëheqjen time si drejtor për Sport, për herë të parë fituam titullin e 'Prishtina Qytet Evropian i Sportit 2024' dhe, po ashtu, për herë të parë e bëmë Prishtinën nikoqire të Lojërave Mesdhetare 2030", ka thënë Rugova. "Falënderoj përzemërsisht çdo person që më mbështeti në këtë rrugëtim të rëndësishëm, duke ndërtuar së bashku

rrugën drejt suksesit. Së bashku punuam me vendosmëri të palëkundur, duke qëndruar pranë sportistëve dhe duke punuar pa pushim për ta avancuar sportin në qytetin tonë. Tani, ndërsa ky kapitull i jashtëzakonshëm mbyllet, marr me vete kujtime të paharrueshme dhe një zemër të mbushur plot me



mirënjohje. Prishtinë, faleminderit për besimin! Herën tjetër do të kthehem edhe më të fortë. Misioni vazhdon", ka deklaruar Rugova.

Kosova mëson kalendarin e ndeshjeve në Ligën e Kombeve

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të enjten mësoi kundërshtarët e grupit në Ligën C të Ligës së Kombeve. "Dardanët" kanë punë me Rumaninë, Qipron dhe fituesin e ndeshjes Lituani - Gjibraltari. Këto dy skuadra luajnë në mars ndeshjen e "play-out"-it për të vendosur se cila prej tyre do të garojë në Ligën C, e cila në Ligën D. Të premten "dardanët" kanë mësuar edhe kalendarin për edicionin e katërt të Ligës së Kombeve, derisa ndeshjen e parë do ta zhvillojnë në stadiumin "Fadil Vokrri", ku do të përballen me rivalin kryesor për pozitën e

parë, Rumaninë. Ndeshja zhvillohet më 6 shtator, në orën 20:45. Tri ditë më pas Kosova do të jetë mysafire e Qipros. Ndërsa në muajin tetor Kosova do të luajë si mysafire kundër Lituaniës ose Gjibraltarit, me datë 12 në orën 15:00, derisa më pas më 15 tetor në orën 20:45 është mikpritëse e Qipros. Dy ndeshjet e fundit Kosova i zhvillon në muajin nëntor. Fillimisht është mysafire e Rumanisë, më 15 nëntor, në orën 20:45, më pas e përmbyll këtë fushatë të Ligës së Kombeve në shtëpi kundër Lituaniës ose Gjibraltarit. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka shprehur optimizëm se "dardanët" do të dalin triumfues të këtij grupi.



"Besoj në ekipin tonë dhe është mirë që para fillimit të edicionit të Ligës së Kombeve do t'i kemi katër ndeshje miqësore, në të cilat trajneri ynë i ardhshëm do të ketë

mundësi ta krijojë ekipin që do të jetë fitues i këtij grupi. Uroj që kjo të ndodhë dhe të ecim tutje në një rang më të lartë", ka theksuar Ademi.

ORARI I PLOTË I KOSOVËS NË LIGËN E KOMBEVE:

- Kosovë - Rumania**
(E premte, 6 shtator 2024, ora 20:45)
- Qipro - Kosovë**
(E hënë, 9 shtator 2024, 20:45)
- Lituani/Gjibraltari - Kosovë**
(E shtunë, 12 tetor 2024, ora 15:00)
- Kosovë - Qipro**
(E martë, 15 tetor 2024, 20:45)
- Rumania - Kosovë**
(E premte, 15 nëntor 2024, ora 20:45)
- Kosovë - Lituani/Gjibraltari**
(E hënë, 18 nëntor 2024, ora 20:45)

Ministri Çeku: Gjithçka gati për nisjen e punimeve në stadiumin 'Adem Jashari'



"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, në "Facebook" ka konfirmuar se së shpejti do të fillojnë punimet për rinovimin e stadiumit "Adem Jashari" në Mitrovicë. Numri një i ministrisë ka bërë me dije se tashmë kanë përfunduar të gjitha procedurat.

"Gjithçka gati për nisjen e punimeve në stadiumin olimpiq 'Adem Jashari' në Mitrovicë. E gjatë dhe e mundimshme ishte rruga për t'i përmblytur të gjitha procedurat që do të duhej të kishin mbaruar në vitin 2019, para nisjes së renovimit. Shpronësimet kanë përfunduar, kushtet e ndërtimit dhe leja ndërtimore janë siguruar, borxhet e akumuluar ndër vite (komunalitet) janë paguar,

kontrata me operatorin është zgjatur, zotimi për buxhet është siguruar", ka thënë Çeku, i cili më pas ka bërë me dije se punët do të monitorohen çdo ditë dhe se nuk do të tolerohet asnjë ditë vonësë. "Punët do t'i monitorojmë në baza ditore. Asnjë vonësë nuk do të tolerohet. Kosova do të bëhet edhe me dy stadione të certifikuar ndërkombëtarisht", ka shtuar ministri Çeku.

Frashëri nënshkruan me Lirinë

PRIZREN, 9 SHKURT - Skuadra e Lirisë ka konfirmuar zyrtarisht nënshkrimin me portierin shqiptar Stivi Frashëri, i cili në të kaluarën ka luajtur me Ballkanin. Pas gjashtë muajve jashtë fushave shkaku i problemeve me kontratë në Arabinë Saudite, Frashëri do t'i kthehet futbollit. Portieri nga Shqipëria është kthyer në

Kosovë, por kësaj radhe jo te Ballkani, por te rivalja rajonale, Liria. Klubi prizrenas ka konfirmuar nënshkrimin me Frashërin. "Portieri i njohur shqiptar, Stivi Frashëri, ka nënshkruar me bardhezinjtë. Frashëri që ka karrierë të pasur në Shqipëri e në Kosovë pritet t'i ofrojë siguri portës prizrenase", thuhet në

njoftimin e Lirisë. Pas nënshkrimit me skuadrën me traditë të madhe në futbollin e Kosovës është shprehur i kënaqur edhe vetë Frashëri. "Jam i fascinuar me pritjen këtu. Liria është klub i madh, e Prizreni e do dhe njeh futbollin. Bashkë me shokët e skuadrës dhe tifozët do të bëjmë më të mirën", ka thënë Frashëri.



Inaugurohet statuja dedikuar Kobe Bryantit

Los Anxhelos, 9 shkurt - Kanë kaluar katër vjet nga tragjedia ajrore që i mori jetën 9 personave në Los Anxhelos (humbën jetën pas përplasjes së helikopterit të tyre). Mes tyre edhe ish-basketbollisti Kobe

Bryant e vajza e tij Gina. Në këtë 4-vjetor, në Los Anxhelos u inaugurua një statujë gjigante dedikuar Kobe Bryant, pesë herë kampion në NBA me fanellën e Lakersave. Fanellë që e veshi përgjatë gjithë karrierës

së tij. Një statujë frymëzuar nga dita kur "black mamba" realizoi 81 pikë në vitin 2006, në ndeshjen ndaj Torontos. Një lojtar që ka frymëzuar miliona njerëz anembanë botës. Në ceremoninë e inaugurimit të

statujës mjaft ikona të NBA-s si Phil Jackson, Kareem Abdul Jabbar, Dereck Fisher, Jeanie Buss dhe bashkëshortja e lojtarit, Vanessa Bryant. E padyshim qindra tifozë që e kanë dashur Kobe Bryant.



Duka: Lojtarët të harrojnë shortin, të mendojnë për 'Euro 2024'

TIRANË, 9 SHKURT - Presidenti i FShF-së, Armand Duka në Supersport e ka komentuar rreth shortit të Ligës së Kombeve, aty ku Shqipëria do të luajë në Grupin 1 të Ligës B së bashku me Çekinë, Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Numri një i Federatës theksoi se do të preferonte Anglinë në vend të Çekisë ndërsa ftoi lojtarët e kombëtares të mendojnë fillimisht për Evropianin dhe më pas për Ligën e Kombeve. "Shorti? Janë skuadra të të njëjtit nivel sportiv, i pranueshëm. Janë skuadra të mira, por nuk mund të thuhet se do të ishim më mirë në një grup tjetër. Jemi një grup i balancuar, i vështirë për t'u parashikuar fitues. Grup interesant. Nëse do të kisha zgjedhur me dorë mund të kishte ndryshime, nuk doja Çekinë. Janë të fortë dhe e kemi provuar, do të më pëlqente pse jo Anglia. Është kënaqësi kur luan kundër të mëdhave dhe fiton eksperiencë", ka thënë Duka. "Ajo që dua dhe që i bëj thirrje futbollistëve është që le të mos mendojnë shumë për këtë short, edhe pse do ta marrim seriozisht, por duhet të përqendrohemi në Evropianin"



futbollistët duhet ta shijojnë Evropianin, ashtu edhe tifozët. Spanja, Kroacia dhe Italia ishin në Ligën A dhe ne ato ikemi në grupin e Evropianit". "Kur konfirmohet Sylvinho apo keni ndonjë plan B? Nuk ka asnjë plan B, nuk e mendoj të ndërpris marrëdhënien me stafin. Ka qenë një periudhë e ngarkuar dhe nuk kemi pasur kohë të ulemi dhe të bisedojmë. Kemi para Evropianin dhe ai ka qenë i përqendruar aty, është një sukses i madh edhe për Sylvinhon që nuk është një nga ata trajnerët me shumë eksperiencë. Por, do ta gjejmë mundësinë të diskutojmë edhe për atë që do ndodhë përtej

Evropianit". Kandidat për president të UEFA-s pas vendimit të Çeferin për të mos rikandiduar? "Asgjë nuk e pengonte Çeferin që të vazhdonte, por edhe unë si futbollistët jam i përqendruar tek Evropiani", u shpreh Duka.


Grupi i Shqipërisë:

Liga B, Grupi 1

Çeki
Ukrainë
Shqipëri
Gjeorgji

Curry magjik i jep fitoren Golden State, Denveri shumë i fortë për Lakersat

Indiana, 9 shkurt - Fitorja e tretë radhazi për Golden State, që mbajnë ende gjallë shpresat për një vend në "play-out". Falë 11 guajtjeve të sakta për tri pikë të Stephen Curry (42 pikë), Warriors mundën me rezultat 131-109 Indianan jashtë fushe. Vijnë momenti i mirë për Clevelandin, që falë fitores me rezultat 118-95 në fushën e Brooklynit (Mitchell 27 pikë), ngjitet në vendin e dytë në Lindje.



Ndalet pas tri fitoresh ekipi i Lakersave, që u mund me rezultat 114-106 nga Denveri. Murray me 29 pikë, Porter me 27 si dhe Jokiq me 24 pikë fituan duelin ndaj Davis e James, që së bashku realizuan 57 pikë. Jashtë fushe fiton edhe Chicago, që mundi me shifrat 118-110 Memphisin, ndeshje ku u dallua DeRozan, autor i 30 pikëve. Moment i mirë

për Phoenixin, që mundi me rezultat 129-115 Utah Jazz, ku protagonistë ishin Durant me 31 pikë e Beal me 30. Minnesota mbron vendin e parë në Perëndim pas fitores me rezultat 129-105 në fushën e Milwaukee. Edwards me 26 pikë ishte i miri për miqtë, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët e Green për Bucks.

REZULTATET

Indiana - Golden State	109-131
Orlando - San Antonio	127-111
Brooklyn - Cleveland	95-118
New York - Dallas	108-122
Memphis - Chicago	110-118
Milwaukee - Minnesota	105-129
Phoenix - Utah Jazz	129-115
Lakers - Denver	106-114
Portland - Detroit	122-128

Kumbulla: Nuk hezitova aspak për t'iu bashkuar Sassuolos

Marash Kumbulla në një prononcim për kanalin zyrtar të klubit, shpjegoi se pse zgjodhi Sassuolon, skuadër ku u huazua deri në fund të sezonit nga Roma. Qendërmbrojtësi shqiptar ka lënë pas krahëve dëmtimin e rëndë.

Tani është gati të rikthehet sërish në fushë, për ta rigjetur formën e tij më të mirë dhe për ta ndihmuar skuadrën e re në realizimin e objektivave sezonalë. Skuadra e Dionisit ndodhet në pozita të vështira, teksa është vetëm një

pikë mbi zonën e ftohtë. "Ndodhi shumë shpejt ardhja ime këtu te Sassuolo. Vetëm një ditë përpara se t'i kryeja vizitat mjekësore u lidh Sassuolo me emrin tim. Unë nuk pata asnjë hezitim apo mëdyshje. I thashë menjëherë agentit tim se

doja të vija këtu. Dhe kështu ndodhi. Bisedova me Bajramin, ai më tha se po më priste te Sassuolo. Tani jam shumë i lumtur. Kam gjetur një grup djemsh të gatshëm dhe me dëshirë për të luajtur e arritur rezultate pozitive. Gjeta,

gjithashtu, një trajner tepër të karikuar dhe entuziast, dhe një ambient të qetë e të bashkuar. Renditja jonë nuk është e mirë, por me punë mund ta përmirësojmë situatën aktuale", u shpreh 24-vjeçari nga Malësia e Madhe.

SHKURT

Muçi i bashkohet Rashicës në Beshiktash

Skuadra e Beshiktashit ka konfirmuar zyrtarisht transferimin e sulmuesit shqiptar Ernest Muçi nga Legia Varshava. Sulmuesi shqiptar ka bërë hapin e madh në karrierë pasi nga kampionati polak do të transferohet në njërin prej tri klubeve më të mëdha turke. Bëhet fjalë për Beshiktashin, i cili ka konfirmuar transferimin e Muçit me anë të faqes zyrtare në rrjetet sociale. "Mirë se vjen në Beshiktash, Ernest Muçi!", thuhet në postimin e klubit turk. Detaje të tjera të transferimit nuk janë bërë publike, por 22-vjeçari shqiptar pritet të nënshkruajë për tri vjet e gjysmë dhe do t'i kushtojë 10 milionë euro. Te Beshiktashi, Muçi do ta gjejë yllin shqiptar të Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica.

De Rossi për ndeshje ndaj Interit: Çdo ekip mund të mposhtet

Tri fitore radhazi në tri ndeshjet e tij të para si trajneri i Romës. Tani Daniele De Rossi thirret për sprovën më të madhe, në "Olimpico" kundër liderit Interit. "Çdo ekip mund të mposhtet. Ne do ta përballojmë këtë ndeshje me guxim e lojtarëve të fortë, ata prej të cilëve jemi ne. Do të duhet guxim, inteligjencë dhe njohuri sepse edhe Interi, që është skuadër më e fortë e Italisë, mund të mposhtet. Interi e do dhe është mësuar ta mbajë topin, por ka situata që mund ta shqetësojë. Ata janë shumë të fortë, por edhe ne jemi të vetëdijshëm që jemi të tillë gjithashtu", ka thënë De Rossi. "Lukaku? Ai duhet ta ndajë aspektin emocional nga ai futbollistik, nëse luan të njëjtën ndeshje si kundër Cagliariar, do të më mjaftojë sepse më pëlqeu shumë se si luajti për skuadrën. Ai do të jetë në gjendje t'i menaxhojë emocionet", ka shtuar De Rossi.

Tuchel: Shkojmë në Leverkusen për fitore

Trajneri i Bayern Munchenit, Thomas Tuchel, ka thënë se të shtunën shkojnë në Leverkusen për t'i mposhtur kryesuesit e Bayer Leverkusenit. Bayerni është dy pikë pas Leverkusenin në renditjen tabelore në Bundesliga. "Ne jemi vetëm dy pikë mbapa. Nuk ka arsye për t'u fshehur. Është koha të tregojmë sa vlejme. Ne do të jemi gati ta sfidojmë Leverkusenin. Do të shkojmë në Leverkusen për të fituar. Është emocionuese që dy skuadra po fitojnë pikë në një nivel kaq të lartë. Jemi plotësisht të fokusuar në atë që mund të bëjmë. Ne duam një paraqitje të jashtëzakonshme", ka thënë Tuchel.

Koeman: Të qenit trajner i Barcelonës i shkakton problem shëndetit mendor

Trajneri i kombëtares holandeze, Ronald Koeman, është dakord me Xavi Hernandezin lidhur me pozitën e trajnerit të Barcelonës. Tekniku holandez ka deklaruar se të qenit trajner i Barcelonës i shkakton probleme shëndetit mendor. "Të qenit trajner i Barcelonës i shkakton problem shëndetit mendor. Është detyra më e vështirë që kam pasur në karrierë, e kam vuajtur shumë sepse kishte presion dhe stres", ka thënë Koeman. "Unë kam pasur një marrëdhënie konfliktuale me Laportan, ndryshe nga Xavi. E kuptoj. Ai kishte qenë vetëm në Katar dhe më pas kaloi në Barcelonë. Nuk ishte mësuar me kritika, kishte marrë vetëm lëvdata. Dhe pastaj shtypi drejton një armë drejt jush. Nëse gjërat nuk shkojnë mirë, është faji i trajnerit. Edhe unë kam vuajtur të njëjtin stres dhe presion", ka deklaruar Koeman.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:219/1
Data 09.02.2024

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024, KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL - MESIMI PËR TË RRRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Qendren e Kompetences Prizren **shpallim këto drejtime:**

I.		
1	Ekonomi -Nepunes Marketingu	1 Paralele 24 nxënës
2	Turizem -Asistent ne zyre informative	1 Paralele 24 nxënës

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2023/2024, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 20 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes/ Leternjoftimin.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve, bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës Qendra e Kompetences në Prizren, nga ora 10:00-14:00.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leutrim Sadria nga Pnishi, Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plote SHFMU "Pjeter Bogdani", Pnish-Gjakovë

- Servete Kastrati nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e Shkollës Fillore "Mazllum Këpuska"

- Rinor Badalli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu" Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

- Besmir Regjaj shpall te pavlefshme certifikatën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Labinot Jasharaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl XIII dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Lirim Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Mirela Balaj Metalijaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Hysni Zajmi"

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

